



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.224/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.224/2025, Anr.225/2025, Anr.228/2025, Anr.230/2025, Anr.231/2025, Anr.232/2025 të datës 27.01.2025.

II. Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 20,000.00 (njëzetmijë) euro.

III. Detyrohet Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 27.01.2025 PZAP-i, i ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.224/2025, Anr.225/2025, Anr.228/2025, Anr.230/2025, Anr.231/2025, Anr.232/2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

- Në ankesën Anr.224/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pretendon se më datë 27.01.2025 Hajdar Sutaj, kryetar i Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka postuar në profilin e tij në facebook një fotografi të zv.

Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur “e pafytyrë”... ”e pa nderë”.... ”e pa moral”.... ” e pa kurrizore” dhe gjithashtu duke i vendosur një shenjë të X-it mbi fotografinë e saj. Parashtruesi i ankesës thekson se po ashtu duke përdorur të njëjtën gjuhë denigruese dhe fyese me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla në tekstin shoqërues ka përfshirë edhe Kryeministrin Albin Kurti duke e quajtur “Krye mashtruesin”.

- Në ankesën Anr.225/2025, pretendohet se më datë 27 Janar 2025, Afrim Demhasaj, përkrahës/mbështetës publik i subjektit politik AAK dhe njëherit vëllai i kandidatit për deputet Arton Demhasaj nga koalicioni politik AAK-NISMA, ka postuar në profilin e tij në facebook një fotografi, të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla me mbishkrimin “*Poshtërsia ka emër*”.

- Në ankesën Anr.228/2025, pretendohet se me datë 27 Janar 2025, kandidati për deputet nga koalicioni AAK-Nisma, Ardian Rama, ka postuar/shpërndarë në llogarinë e tij në Facebook, në artikull të portalit Rahoveci24.com, me titull” Rama: Haradinaj sakrifikoj gjithçka, Donika Gërvalla një e pafytyrë që hedh baltë mbi një legjendë”. Kandidati për deputet Ardian Rama duke përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes është deklaruar për portalin Rahoveci24.com si në vijim:” *Donika Gërvalla është e pafytyrë që ndjell urrejtje për të përçarë popullin. Kontributi i Ramush Haradinajt do të jetë thellë i gravuar në historinë e Republikës së Kosovës. Nuk ka askush që mund të hedhë baltë mbi një legjendë të gjallë sidomos io një e pafytyrë si Donika Gërvalla që nxit përçarje në mes të Deçanit. Ajo nuk do t'ia dalë kurrë sepse populli e di të vërtetën u shpreh Rama.*”, dhe se ky artikull është duke vazhduar që të qarkullojë në Facebook.

-Në ankesën Anr.230/2025 pretendohet se me 26 Janar 2025, kandidati për deputet nga koalicionit AAK-Nisma, Zafir Berisha, ka postuar në Llogarinë e tij në Facebook, fotografi me tekst shoqërues, me llogo dhe numër të subjektit politik dhe numrin e tij në listën e votimit, duke përdorur gjuhë denigruese dhe fyese me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kryeministrit Albin Kurti duke i quajtur ‘/Hajdut që qeverisin vendin’. Me qëllim të vazhdimit të dëmtimit elektoral dhe nxitjes së urrejtjes dhe me qëllim të shpërndarjes së këtij materiali, më datë 26 Janar 2025/ në orën 21:31, në portalin Insajder është publikuar një artikull me fotografitë e lartcekura të kandidatit për deputet, Zafir Berisha, dhe fjalimin e tij të mbajtur në një tubim në Prizren i titulluar ” Qytetarët e Prizrenit në rresht me Kosovën Fituese 137 për ti dhënë fund hajdutëve që qeverisin vendin”, dhe se ky artikull është duke vazhduar që të qarkullojë në Facebook.

- Në ankesën 231.2025 pretendohet se më 27 Janar 2025, Rifat Stojkaj, drejtor i Drejtoratit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në Kuvendin Komunal në Deçan, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka postuar në profilin e tij në facebook një fotografi të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur "Vetëm një person si kjo grua, histerike, e patak, e paaftë"... .."Duhet guxim me qenë edhe e poshtë, dhe këtë e bën më së miri Donika Gërvalla" dhe gjithashtu duke i vendosur një shenjë të X-it mbi fotografinë e saj.

Ndërsa, duke përdorur të njëjtën gjuhë denigruese dhe fyese me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika

Gërvalla në tekstin shoqëruar ka përfshirë edhe Kryeministrin Albin Kurti duke e thënë" se kush është Donika Gërvalla dhe i shefi i saj , Albin Kurti, pra, kap njanin e mëshoj tjetrit, njësoj"

-Në ankesën 232/2025 pretendohet se me 27 Janar 2025, Muhamet Asllani, nga fshati Brovinë, Komuna Gjakovë, mbështetës i subjektit politik AAK, për qëllime të fushatës dhe me qëllim të vazhdimit të dëmtimit elektorale dhe nxitjes së urrejtjes ndaj zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla, ka rishpërndarë në profilin e tij në Facebook, statusin e Kryetarit të Kuvendit Komunal në Deçan, Hajdar Sutaj, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cilin ka postuar një fotografi të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur "e pafytyrë" "e pa nderë",..... "e pa moral"....."e pa kurrizore "dhe gjithashtu duke i vendosur një shenjë të X-it mbi fotografinë e saj, Ndërsa, duke përdorur të njëjtën gjuhë denigruese, fyese dhe nxitjes së urrejtjes ndaj zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla në tekstin shoqëruar është përfshirë edhe Kryeministri z. Albin Kurti duke e quajtur "Krye mashtruesin".

Parashtruesi i ankesave thekson se përmes këtyre veprimeve janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi dhe linket e publikuara në facebook.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 29.01.2025 në ora 10:00

Në përgjigje në ankesat e paraqitura me datë 29.01.2025 Koalicioni AAK-Nisma ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e subjektit politik LVV, ku në Ankesën Anr.224, postimi i z.Hajdar Sutaj nuk përmbush elementet e dispozitës e cila ndalon gjuhën që nxit ose provokon dhunë apo urrejtje dhe se përdorimi i fjalëve "e pafytyrë", "e panderë" dhe "e pa kurrizore" përben kritikë dhe mos dakordsi politike dhe jo mesazh që nxit dhunë kundër zonjës Gërvalla apo pasurisë së saj. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë po ashtu thekson se sa i përket shenjës "X" e njëjta është përdorur si simbolik proteste dhe si formë e shprehjes së pakënaqësisë politike, pa pasur qëllim të provokojë apo nxisë veprime të dhunshme.

Në përgjigjen në ankesë Anr.225, Koalicioni AAK-Nisma kundërshton pretendimet e subjektit politik LVV, duke i cilësuar ato si të pabaza, sepse në asnjë rrethanë, z. Hajdar Sutaj nuk ka shfrytëzuar gjuhë që nxit dhunë apo që përhap urrejtje ndaj znj. Gërvalla. Ankuesja fillimisht ka theksuar në ankesën e saj se z. Afrim Demhasaj është vëlla i kandidatit për deputet, z. Arton Demhasaj. Megjithatë, kjo rrethanë jo vetëm që është e parëndësishme për rastin konkret, por ankuesja as nuk ka mundur ta vërtetojë këtë pretendim, përveç faktit se të dy palët ndajnë të njëjtin mbiemër. Ndërkaq përdorimi i mbishkrimit "Poshtërsia ka emër" mbi fotografinë e znj. Gërvalla përfaqëson një kritikë ndaj deklaratave të saj denigruese ndaj z. Ramush Haradinaj dhe z. Daut Haradinaj, por nuk përmban elemente që mund të interpretohen si nxitje direkte apo të tërthortë për kryerjen e një akti të dhunës.

Në përgjigjen për ankesën Anr.228 thekson se kjo shprehje e z. Ardian Rama është nxjerrë totalisht jashtë kontekstit nga ana e portalit "Rahoveci24.com". Z. Rama, në asnjë moment, nuk ka pasur qëllim të fyejë apo denigrojë znj. Donika Gërvalla, por ka shprehur thjesht indinjatën e tij ndaj deklaratave të saj të bëra në Deçan, për të cilat ne gjithashtu kemi paraqitur ankesë

pranë PZAP-së. Në deklarinimin e tij, z. Rama ka theksuar se: "Kontributi i Ramush Haradinajt do të jetë thellë i gravuar në historinë e Republikës së Kosovës. Nuk ka askush që mund të hedhë baltë mbi një legjende të gjallë..." këto shprehje janë një reagim politik ndaj veprimeve të publikuara dhe nuk mund të konsiderohen si shkelje të dispozitave ligjore për shkak të natyrës së tyre kritike, por në asnjë rast fyese.

Në përgjigjen për ankesën Anr.230, koalicioni kundërshton pretendimet e subjektit politik LVV, duke theksuar se në asnjë rrethanë, z. Zafir Berisha nuk ka përdorur gjuhë që nxit dhunë apo që përhap urrejtje ndaj z. Albin Kurti, gjë kjo e cila mund të vërtetohet nga vet fotografitë e bashkëngjitura ankesës së parashtruar nga subjekti nga të cilat shihet se fjalori i përdorur nga z. Zafir Berisha është shumë herë më i pastër nga fjalori i përdorur nga LVV, përkatësisht z. Albin Kurti përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj fushate zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesën Anr.231, koalicioni AAK, Nisma dhe Lista Ideal, përmes kësaj përgjigjeje, kundërshton pretendimet e subjektit politik LVV, duke i cilësuar ato si të pabaza, dhe asnjë rrethanë, z. Rifat Stojkaj nuk ka shfrytëzuar gjuhë që nxit dhunë apo që përhap urrejtje ndaj znj. Gërvalla, sepse ajo çka shihet nga fotografitë mbi të cilat ankuesi e ka mbështetur ankesën e saj, është një shprehje popullore (kap njanin e mëshoj tjetrit), e cila shprehje gjen përdorim të gjerë në popull e në veçanti kur në pyetje janë cilësitë e personave / sendeve të cilat krahasohen, njëri tjetrit për cilësitë për të cilat krahasohen, apo më mirë të themi mungesë cilësive për të cilat krahasohen, atëherë përdoret shprehja e përdorur nga z. Rifat Stojkaj. Pra shprehja e përdorur nga z. Stojkaj në rastin konkret është totalisht nën kuadrin e shprehjeve të cilat i dëgjojmë çdo ditë duke filluar nga fëmijët e deri te të vjetrit, e rrjedhimisht as nuk përbëjnë nxitje të gjuhës së urrejtjes ndaj znj. Gërvalla.

Në përgjigjen në ankesë Anr.232 thekson se fillimisht kërkojmë nga PZAP që të shoh me vëmendje ankesën e ankuesit LVV, e në veçanti pjesën ku e njëjta thekson se dikush nga mbështetësit e AAK - në rastin konkret z. Muhamet Asllani, KA RISHPËRNDARË një postim në Facebook. Për subjektin AAK është e paqartë se në cilën dispozitë ligjore përcaktohet se rishpërndarja e një postimi përbën shkelje të çfarëdollojshme nga Ligji për LZP.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.224/2025, Anr.225/2025, Anr.228/2025, Anr.230/2025, Anr.231/2025, Anr.232/2025, të paraqitura me datë 27.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.224/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidat dhe simpatizant të subjektit politikë AAK, dhe atë: Hajdar Sutaj, kryetar i Kuvendit Komunal në Deçan nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka postuar në profilin e tij

në facebook një fotografi të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur "e pa fytyrë"....."e pa nderë"....."e pa moral"....." e pa kurrizore" gjithashtu duke i vendosur një shenjë të X-it mbi fotografinë e saj; Afrim Demhasaj, përkrahës/mbështetës publik i subjektit politik AAK, ka postuar në profilin e tij në facebook një fotografi, të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla me mbishkrimin "Poshtërsia ka emër", kandidati për deputet nga koalicioni AAK-Nisma, Ardian Rama, ka postuar/shpërndarë në llogarinë e tij në Facebook, në artikull të portalit Rahoveci24.com, me titull "Rama: Haradinaj sakrifikoj gjithçka, Donika Gërvalla një e pafytyre që hedh baltë mbi një legjendë"; kandidati për deputet nga koalicionit AAK-Nisma, Zafir Berisha, ka postuar në Llogarinë e tij në Facebook, fotografi me tekst shoqërues, me llogo dhe numër të subjektit politik dhe numrin e tij në listën e votimit, duke i quajtur 'Hajdut që qeverisin vendin', Rifat Stojkaj, drejtor i Drejtoratit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në Kuvendin Komunal në Deçan, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka postuar në profilin e tij në facebook një fotografi të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur "Vetëm një person si kjo grua, historike, e patakt, e paaftë", dhe Muhamet Asllani, mbështetës i subjektit politik AAK, për qëllime të fushatës dhe me qëllim të vazhimit të dëmtimit elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla, ka rishpërndarë në profilin e tij në Facebook, statusin e Kryetarit të Kuvendit Komunal në Deçan, Hajdar Sutaj, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cilin ka postuar një fotografi të zv. Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme znj. Donika Gërvalla duke e quajtur "e pafytyrë" "e pa nderë",..... "e pa moral"....."e pa kurrizore ' ,

Paneli vlerëson se gjuha e përdorur si më lartë nga kandidatët për deputet dhe simpatizuesit e AAK është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me kandidaten për deputete Donika Gërvalla dhe subjektin politik LVV dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika l.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Sipas Panelit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt znj. Donika Gërvalla dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti si dhe të respektojnë dinjitetin dhe integritetin e të tjerëve. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-

së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik AAK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 224/2025 më datë 30.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.